



Së bashku të mbështesim
të miturit që të jetojnë
fëmijërinë larg kriminalitetit!

**QENDRA E PARANDALIMIT
TË KRIMEVE TË TË MITURVE
DHE TË RINJVE**

QPKMR
*e shtrin veprimtarinë e
saj në të gjithë territorin
e vendit.*



Kontakt:

Adresa: Bulevardi "Zog I-rë", Tiranë 1000

Telefon: ++ 355 (0) 696409140

www.qpkmr.gov.al

*Ky material u përgatit nga Instituti Shqiptar
për Studime Ligjore dhe Territoriale (Qendra
ALTRI) për Ministrinë e Drejtësisë dhe Zyrën
e UNICEF-it në Shqipëri, me mbështetjen
financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme
të Norvegjisë.*



Norwegian Ministry
of Foreign Affairs



A.L.T.R.I.

unicef 
for every child

Çfarë është Qendra e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR)?

QPKMR është një person juridik publik, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, në zbatim të parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, e cila ka si **mision kryesor** realizimin e veprimtarisë rehabilituese dhe riintegruese nëpërmjet mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së të miturve/të rinjve pas kryerjes së dënimit.

Përgjegjësitë e QPKMR

- **Bashkëpunon me strukturat qendrore** (Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të Mitur dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës) **si dhe me strukturat në nivel vendor** (Bashkitë dhe Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës) për vlerësimin e nevojave të të miturit jashtë institucionit si dhe për përgatitjen e planit të rishoqërimit dhe të rehabilitimit të të miturve duke synuar shmangien në ripërfshirjen e të miturit në rrugën e krimit.

- **Bashkëpunon me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës** për ndjekjen, koordinimin e masave, mbikëqyrjen e ecurisë së zbatimit si dhe sigurimin e përmbushjes së Planit të rishoqërimit dhe të rehabilitimit të të miturve për të paktën gjashtë muaj nga kryerja e dënimit ose e lirimit me kusht e të miturit.

- **Administron** Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Miturit, me qëllim evidentimin e të dhënave që lidhen me datat e fillimit dhe të mbarimit të dënimit.

- **Ndjek procesin e trajnimit e të specializimit të profesionistëve** për drejtësinë për të miturit.

- **Mbikëqyr cilësinë e ofrimit të shërbimit** ndaj të miturit.



Plani i rishoqërimit dhe rehabilitimit të të miturit hartohet jo më pak se tre muaj para datës së mbarimit të dënimit, së bashku me të miturin dhe familjen e tij dhe në varësi të nevojave, i ofron të miturit:

- veshje, sigurimin e shpenzimeve të udhëtimit për në banesë dhe strehim të përshtatshëm;
- mbështetje psikologjike;
- mundësimin e ndjekjes së kurseve të formimit profesional, arsimit apo punësimit pas lirimit;
- sigurimin e kujdesit të nevojshëm nga autoritetet shëndetësore, përfshirë edhe në rastet e aftësisë së kufizuar, varësisë nga droga apo të sëmundjeve mendore.

Parandalim, Rehabilitim, Riintegrim!

Vizioni i QPKMR

Të parandalojë kriminalitetin tek të miturit dhe të rinjtë duke promovuar zhvillimin pozitiv nëpërmjet zbatimit të programeve parandaluese, rehabilituese dhe riintegruese!



Për më shumë informacion mbi Qendrën e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve, konsultoni faqen e internetit: www.qpkmr.gov.al